



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SHUPËSTINA OPŠTINA
SKENDERAJ

Nr. 01-060/01-0031736/25

Data 04.08.2025



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupstina Opštine/Municipal Assembly

| | |
|-----------------------|---|
| Data/Date: | 04.08.2025 |
| Nga/Od/From | U.d. i Udhëheqësit të Sekretarisë së Kuvendit, z. Adina Kabashi |
| Për/Za/To: | Kryetarin i Komunës, z. Fadil Nura |
| CC | Kryesuesja e Kuvendit Komunal të Skenderajt, z. Adeline Spahiu |
| Temu/Subjekat/Subject | Raporti për ecurinë e takimit të parë publik 2025. |

Duke u bazuar në nenin 18 dhe nenin 30, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, hartohet ky raport:

Me njoftimin nr. 02-400/01-0022594/25, Kryetari i Komunës, z. Fadil Nura ka ftuar qytetarët e Komunës së Skenderajt, që më datë 30.06.2025 (e hënë), në ora 14:00, në sallën e Kuvendit Komunal të Komunës së Skenderajt, të marrin pjesë në takimin e parë publik 2025.

Publikimi i njoftimit në webfaqen zyrtare të Komunës: <https://skenderaj.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/06/20250627160411-1.pdf>

TAKIM PUBLIK ME QYTETARË

Më datë: 30.06.2025 (e hënë), në ora 14:00, në sallën e Kuvendit Komunal të Komunës së Skenderajt është mbajtur takimi publik.

Të pranishëm: Kryetari i Komunës, z. Fadil Nura; Drejtori për Buxhet dhe Financa, z. Ismet Aliu; Drejtori i Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Ambientit, z. Driton Mulaj; Drejtori për Shërbime Publike, z. Alban Shala; Drejtori i Administratës, z. Hamit Geci dhe zyrtarë komunal, përfaqësues të OJQ-ve, qytetarë të ndryshëm.

Në web faqe: <https://skenderaj.rks-gov.net/news/eshte-mbajtur-takimi-i-pare-publik-per-vitin-2025/>

Takimi publik filloi në orën 14:00.

Takimin publik e shpalli të hapur Kryetari i Komunës, z. Fadil Nura.

| Kërkesat / Sugjerimet / Komentet | Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm) |
|--|---|
| <p>Agron Istogu: Një pyetje rreth lagjes tre (3) rrugës kryesore për Mitrovicë – Drenas, ndriçimi publik në atë pjesë ka moti që nuk funksionon. E di që është në nënmbikëqyrjen e nivelit qendror, kish me qenë mirë në të ardhmen ta kemi një gjendje më të mirë se sa e kemi sot.</p> | <p>Kryetari i Komunës, z. Fadil Nura: Z. Agron, kjo rruga me katër korsi, kemi bërë kërkesa të përsëritura nivelit qendror për rregullim të ndriçimit, dhe fatkeqësisht nuk kemi marrë asnjëherë përgjigje. Ne edhe pse nuk kemi kompetencë, e kemi autorizuar ndërmarrjen Eko-Natyrë që të bëjë pastrimin e asaj rrugë. Semaforët gjithashtu kanë defekte dhe i kemi lajmëruar me kërkesa dhe email, nuk janë përgjigjur, është një kërkesë me vend, sidomos këtë kohë pasi i kemi edhe mërgimtarët, është e domosdoshme pasi që rritet edhe çarkullimi i lëvizjes.</p> |
| <p>Halil Thaqi: Në fshatin Vojnike, janë disa kërkesa në dy lagje janë të ndara prej kanalizimit dhe komplet fshati ka kanalizim dhe vetëm ato dy lagje nuk janë të përfshira në kanalizim, lagja Oztrim dhe Turian, dhe çdo ditë kam telefonata a do jenë të përfshira në vitin e ardhshëm?</p> | <p>Drejtori i DUMA-së, z. Driton Mulaj: Z. Halil sa i përket kanalizimit, ne para 2-3 jave vetëm se i kemi përfunduar telashet më të mëdha që i kemi pasur në fund të fshatit Vojnik që e kemi dërguar deri në kufi të Klinës së Begut, janë edhe ato dy lagje pa u kyçur, megjithëse njëra përballë shkollës aty ka pasur probleme pronësore para dy viteve, por e kemi në kontratë dhe janë të përfshira të gjitha lagjet dhe besoj që gjatë vitit të ardhshëm do përfundohen nëse nuk kemi ndonjë telashe.</p> |
| <p>Sami Beqiri: Pyetja e parë është ndriçimi i lagjeve në bashkësitë lokale të Qirezit, dhe pyetja e dytë ka të bëjë me kanalizimin e ri dhe të vjetër ku është shumë afër njëri me tjetrin, po flas për lagjen tonë, kanalizimi i vjetër gropa skeptike është shumë afër shtëpive, kundërmon erë çdo herë.</p> | <p>Kryetari i Komunës, z. Fadil Nura: Ndriçimi publik në fshatra është duke u realizuar, në terren janë duke punuar 4 ekipe, njëra që ka punuar në fshatin Polac, planifikoj që ta dërgoj të punojë në Bashkësinë e Qirezit, sidomos në pjesët që ka më shumë popullsi.</p> <p>Drejtori i DUMA-së, z. Driton Mulaj: Z. Beqiri ajo gropa skeptike është punuar para 17-18 vjetëve, në</p> |

| | |
|---|--|
| | <p>vitin 2007-2008, do të dalim në terren ta shohim gjendjen dhe të shikojmë mundësinë a mund të shkarkojmë apo jo, se mund të jenë afër njëra tjetres por mund të mos ketë rënie për t'u shkarkuar.</p> |
| <p>Fitim Gashi: Përshëndetje për të gjithë, si banor i fshatit Kryshec, shqetësimin e kam për disa rrugica që nuk janë përfshirë në asfaltim. Këtë vit është bërë një punë e mirë me ndriçimin e fshatit, kërkesë tjetër, tek shkolla SHFMU "Shaban Jashari" është krijuar një deponi e mbeturinave afër shkollës dhe është shumë rrezik pasi që është afër shkollës, kisha kërkuar që sa më shpejt të largohet.</p> | <p>Kryetari i Komunës, z. Fadil Nura: Z. Gashi, tek kërkesa juaj për asfaltimin e rrugicave në Kryshec, kemi kërkesa nga të gjitha fshatrat, jemi duke punuar në fshatin Qirez, kemi me dalë në fshatin Krasaliq, jemi duke punuar në Kllodernic, kemi kryer një pjesë të Kopiliqt, Runik, Vojnik. Kryshec e di që i kemi pasur përfunduar disa rrugica por ende ka kërkesa, kemi me vazhduar ende me këto degëzime, por këtë vit është problem t'i përfundojmë të gjitha. Për kërkesën për grumbullimin e mbeturinave është shumë kërkesë e qëlluar dhe sa më shpejt drejtori i DSHP dhe drejtori i DUMA të gjejnë një lokacion tjetër më adekuat.</p> |
| <p>Milaim Koci: Përshëndetje për të gjithë, i përmendët disa fshatra për rrugica, dhe kërkoj që edhe në Polac të asfaltohen disa rrugica që kanë mbetur.</p> | <p>Kryetari i Komunës, z. Fadil Nura: Z. Milaim, e di që edhe fshati Polac ka nevojë që disa rrugica të asfaltohen. I kemi të inçizuara dhe sa më shpejt brenda kapaciteteve financiare do t'i rregullojmë.</p> |
| <p>Abedin Abazi: Përshëndetje për të gjithë, unë kam një kërkesë rreth kanalizimit, lagjja Smaka, Abazi dhe Miftaraj nuk janë të kyçura në kanalizim, diku rreth 10 shtëpi, vetëm kanë me u lidhur në kanalizim por duhet të shpohet asfalti.</p> | <p>Drejtori i DUMA-së, z. Driton Mulaj: Z. Abedin do të bëjmë zgjidhje sa më shpejtë, por tash jemi në lagje që kanë banorë më shumë 40-50 shtëpi dhe duke ardhur tek lagjet ku kanë banorë më pak, do të bëjmë një inçizim dhe ta shikojmë a ka rënie për t'u shprazur në gropë skeptike.</p> |
| <p>Agron Istogu: Në lagjen ku banoj unë, lagjen tre (3), janë dy autolarje, me shumë gjasë nuk i paguajnë shportat e mbeturinave</p> | <p>Kryetari i Komunës, z. Fadil Nura: Z. Agron, ne po intervenojmë me inspektim, shpesh edhe tek ndërtuesit ku po abuzojnë me këtë çështje, do ta kemi</p> |

dhe çdo natë ose çdo 2 netë, i ndezin mbeturinat dhe kundërmon ajri në tërë lagjen.

parasysh atë rast dhe inspektorati brenda kompetencave do marrë masa.

Albulena Lushtaku: Përshëndetje Kryetar dhe të pranishëm, unë e kam një telashe në rrugën ku jetoj, rr. Rexhep Mala lagjja 2, vitin e kaluar ujsjellësi ka punuar dhe i kanë lënë disa gropa të hapura dhe kanë mbetur shumë keq, desha ta di ku mund ta adresoj ankesën?

Kryetari i Komunës, z. Fadil Nura: Znj. Albulena, nuk është vetëm ai rast dhe e dimë që kompania e ujsjellësit ku ndërhyr i lëna ashtu ndoshta edhe më keq se sa kanë qenë. Ne jemi duke i marrë përsipër t'i rregullojmë këto probleme përmes kontratës.

Shaban Lushtaku: Përshëndetje Kryetar dhe të pranishëm, unë e kam një kërkesë për një rrugë 100m pa kycje në lagjen Lushtaku, a ka mundësi t'i bëhet një zgjidhje?

Kryetari i Komunës, z. Fadil Nura: Z. Shaban në kontratë e kemi, po problemi është që nuk kemi mjete financiare për shkak të kontratës kolektive, po na i marrin në thesar dhe po na ndalin punën që është goxha sfiduese.

| Tema | Zyra | Pjesëmarrës | Vendi Data | Komentet | 1.Njoftimi 2.Takimi Publik |
|-------------------------------------|--------------------------------------|------------------|--------------------------------|-------------|--|
| Takimi i Parë Publik për vitin 2025 | Zyra për Informim Zyra e Kuvendit | F M T 6 23 29 | Salla e Kuvendit 30.06.2025 | 11 Komentet | 1. https://skenderaj.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/06/20250627101-1.pdf 2. https://skenderaj.rks-gov.net/news/eshte-mbajtur-takimi-pare-publik-per-vitin-2025/ |

Bashkangjitur në këtë raport janë edhe këto dokumente:

Njoftimin publik për Takim Publik

Listat e nënshkrimeve të pjesëmarrësve në Takimin Publik










Procesverbal nga Takimi Publik

Lista e nënshkrimeve të pjesëmarrësve nga takimi i parë publik 2025 i mbajtur nga kryetari i komunës.

Vendi: Salla e Kuvendit Komunal, kati IV

Datë: 30/06/2025

Ora: 14:00

| Emri | Mbiemri | Nënshkrimi |
|--------------|------------|---|
| SHARIPOVA | RAMA |  |
| Donika | Gjergji |  |
| Rijet I | Byrraktari |  |
| Shyqeni | Geci | Shyqeni |
| BESMIK | SMUKIJA | B. Smukija |
| JETON | OSMANI |  |
| Egzon | Bulqizi | Egzon |
| MIRADITJE | BULLQI |  |
| Kosovare | Ahmeti |  |
| Valbona | Hoti |  |
| Sebahate | Sylani | S.S |
| Mirsad | Gashi |  |
| Fadil Beqiri | Beqiri | |
| BESMIK | Zabeli |  |
| BLERARD | Haxhi | Haxhi |

| | | |
|--------------|-----------|------------|
| AGRON | ISTOGU | |
| Muham | KOC | |
| Shaleom | Lushkabeu | Shushkabeu |
| HALIL THAQI | THAQI | H. TH |
| Sami | Bezir | Sami |
| FITIM | GASHI | FITIM |
| Abedin | Abazi | Abedin |
| Dritan | Syla | Dritan |
| VISAR | SHADANI | |
| ABDOR | GEÇI | ABDOR |
| LHI | KABASHI | Kabashi |
| Abulena | Lushkabeu | Abulena |
| PARDAN SHASA | | |
| ANDULLA | GEÇI | |
| | | |
| | | |
| | | |
| | | |
| | | |